



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Tiranë më 11.07.2016
Dokument parlamentar

R A P O R T

Për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.7895, datë 21.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi shqyrtoi në mbledhjen e datës 11.07.2016 në parim dhe nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.7895, datë 21.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”..

Në këtë mbledhje për të shpjeguar më gjerësisht përmbajtjen dhe qëllimin e këtij projektligji, ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.

Qëllimi i projektligjit:

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është plotësimi i vakumit ligjor të krijuar në Kodin Penal, nga vendimi nr.9, datë 26.2.2016, i Gjykatës Kushtetuese. Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese vendosi shfuqizimin e paragrafëve të pestë dhe të gjashtë, të nenit 278, të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013 dhe ndryshuar me ligjin nr.98/2014.

Këto dy paragrafë parashikonin se: *“Mbajtja e armëve, e bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.*

Kur vepra penale kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.”

Në gjykimin kushtetues që pësuan këto paragrafë, u shfuqizuan, me arsyetimin se mbartin probleme kushtetutshmërie, për shkak të dënimit dukshëm joproporcional. Pra marzhi i dënimit të parashikuar për këto vepra penale ishte tepër i madh dhe jo proporcional me qëllimin e tyre dhe frymën e Kodit Penal në tërësi.

Në këto kushte në Kodin Penal mbetj e paparashikuar si rrethanë e posaçme mbajtja e armëve, bombave, minave dhe lëndëve plasëse në mjetet e motorizuara apo në mjedise publike, që, për shkak të rrezikshmërisë që paraqet, në krahasim me mbajtjen e tyre në banesë, duhet të dënohet me një masë dënimi më të ashpër.

Siç edhe Gjykata Kushtetuese shprehet, përcaktimi me ligj i veprave penale, si dhe caktimi i llojit dhe i masës së dënimit për to është në diskrecion të ligjvënësit, në përputhje me nevojat e vendit dhe të shoqërisë për parandalimin e kriminalitetit. Balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis së drejtës së shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, dhe mbrojtjes të të drejtave dhe lirive të individit, nga ana tjetër.

Për këtë arsye dhe për sa është shprehur Gjykata Kushtetuese, sanksionet penale të propozuara në nenin 278, të riformuluar, me anë të këtij projektligji janë menduar të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, veçanërisht për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë.

Gjatë diskutimit si në parim ashtu edhe nen për nen të projektligjit, anëtarët e komisionit ngritën shqetësimin mbi aplikimin e nenit 278, përpara se ai të shpallej antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese. Fakti që ndryshimet e reja mbi këtë dispozitë, në marzhin e dënimit kanë një diferencë të madhe me atë të shfuqizuar por të aplikuar nga ana e gjykatave nuk duket i drejtë në aspektin human por edhe në garantimin e barazisë para ligjit. Për këtë qëllim ju propozua Ministrit të Drejtësisë, nga ana e komisionit, të ndërmarre nismat e nevojshme ligjore duke aktivizuar instrumentet kushtetues që të çojnë në zgjidhjen e kësaj kundërshtie.

Gjithashtu Komisioni për Sigurinë Kombëtare, i sugjeron Komisionit përgjegjës për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut që neni 2 i projektligjit, i cili riformulon nenin 278 të Kodit të Penal të ndahet në dispozita të veçanta për qëllime të qartësisë dhe aplikimit të tij më të mirë në praktikë.

Në përfundim të diskutimeve, duke vlerësuar rëndësinë dhe domosdoshmërinë e këtij projektligji, Komisioni për Sigurinë Kombëtare me shumicën e anëtarëve të pranishëm miraton projektligjin si dhe shprehet dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

Relator

Luan Rama

Kryetar

Spartak BRAHO